



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.22.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË RREGULLATORIT
PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjes dhe Kanalizim në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga, Fejzullah Fejza (Udhëheqës Ekipi), dhe Refiqe Morina (anetare ekipes).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	10
4 Qeverisja.....	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP.....	17
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	19


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Zyres së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2014 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Zyres së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 14 Shtator 2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 200/1700 Opinion i Pamodifikuar).

Konkluzioni i përgjithshëm


Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Ne ishim ne gjendje të marrim siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në disa fusha, por kemi identifikuar dhe dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Dobësitë janë të shpjeguara më në detaje në brendi të raportit.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin menaxhmentin e Zyres së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe aktiviteteve operacionale. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra për vitin 2013. Kjo paraqet nevojë për veprime shtese, deri në adresimin e plotë për të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të Zyres së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe njërive të saj dhe të gjeturat tona në lidhje me procedurat e prokurimit, si dhe Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në pjesën kryesore të këtij raporti.

Konkluzionet dhe Rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Drejtorit - auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Drejtori i ZRRUK-ut. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë raport Drejtori është pajtuar.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Kanalizim (ZRRUK) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarrë nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Cilësia e PVF-ve në përgjithësi ishte e mirë, u identifikuan vetëm një numër i vogël gabimesh jo materiale. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF të cilës i kemi referuar më lart, ishte e saktë në të gjitha aspektet.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 200/1700 **Opinion i Pamodifikuar**).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

PVF të ZRRUK duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me RrF nr. 03/2013 dhe Kërkesat e Rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare;
- Kërkesat Buxhetore dhe Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Draft plani i prokurimit me kohë; dhe
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetë vlerësimit.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 24 nëntor 2014, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin Menaxhmentin e ZRRUK-ut në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen aktiviteteve operative. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2013. ZRRUK, ka treguar gatishmëri të plotë për të adresuar rekomandimet tona të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2013.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të ZRRUK-ut të vitit 2013 ka rezultuar me katër rekomandime kryesore. ZRRUK kishte pregaditur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do të adresoheshin rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, tri rekomandime janë adresuar plotësisht ndërsa një rekomandim nuk ishte adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 1- Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Vetëm një rekomandim i vitit të kaluar nuk është zbatuar edhe pse ZRRUK kishte bërë përpjekje që të njëjtin ta adresoj, mirëpo nuk kishte staf të mjaftueshëm tek i cili do të barteshin detyrat e përcaktuara. |
| Rreziku | Mungesa e stafit të nevojshëm, ndikon në ndarje jo të drejtë të detyrave dhe mund të reflektoj në kontrolle jo adekuate në fusha të përcaktuara. |
| Rekomandimi 1 | Drejtori duhet të konsideroj dhe të rishikojë mundësit, që me rastin e planifikimit të buxhetit të jepë arsyet për stafin e nevojshëm në mënyrë që të ketë një ndarje adekuate të detyrave. |

4 Qeverisja

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

ZRRUK ka një plan të organizimit të tyre, të përcaktuara dhe lokalizuara përgjegjësitë dhe të identifikuar linjat e raportimit për të gjitha aspektet operacionale të saj, duke përfshirë kontrollet. Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga ZRRUK. Vetëvlerësimi, është përgatitur dhe dorëzuar me kohë në të cilën janë paraqitur komponentët e caktuara të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kontrollet efektive bëhen në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar me përjashtim të disa dobësive të cekura në këtë raport.

Megjithatë, ne kemi gjetur se, ndërkohë që kontrollet mbi të hyrat janë të forta dhe po zbatohen në mënyrë efektive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë kompensimet për punët shtesë dhe menaxhimi më efikas i llogarive të arkëtueshme.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ZRRUK, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	359,000	334,318	324,106	313,213	318,024
Granti i Qeverisë -Buxheti	359,000	334,318	324,106	313,213	318,024

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 24,683€. Kjo ulje është ndikuar nga vendimi i Qeverisë për shkurtime të buxhetit në kategorinë Mallra dhe Shërbime në nivel 15%.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	359,000	334,318	324,106	313,213	273,323
Pagat dhe Mëditjet	194,450	194,450	188,455	163,818	156,494
Mallrat dhe Shërbimet	156,900	133,365	130,391	143,958	112,303
Shërbimet komunale	7,650	6,503	5,260	5,438	4,526

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Duke marrë në konsideratë shkurtimin e buxhetit të ndikuar nga vendimi i Qeverisë prej 15% në kategorinë Mallra dhe Shërbime, struktura e buxhetit fillestar ka mbetur pothuajse i pandryshuar. Niveli i shpenzimit të fondeve ka treguar një performancë të mirë financiare prej 97%. Ndërsa rritja në nivelin e shpenzimit të Pagave dhe Mëditjeve është ndikuar nga vendimi i Qeverisë për rritje prej 25% të Pagave.

Tabela 3. Të hyrat vetjake – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat nga taksat e licencimit	359,000	334,318	364,370	326,586	225,309
Totali	359,000	334,318	364,370	326,586	225,309

Të gjitha të hyrat e inkasuara i janë paguar Buxhetit të Kosovës (BK). Totali i të hyrave të inkasuara është më i lartë sesa projeksionet buxhetore (si ato fillestare poashtu edhe ato pas rishikimit) dhe kjo tregon një performancë më të mirë të ZRRUK-ut. Përmes aktiviteteve të saj ZRRUK-u ka bërë përpjekje si dhe ka arritur që të arkëtoj shuma të cilat nuk i ka paraparë se mund të i realizoj në buxhetin fillestar.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga ZRRUK-u në vitin 2014 ishin në total 364,370€, të cilat ishin më të larta nga projeksionet buxhetore fillestare për 1.5%. Rritja e të hyrave është rezultat i një angazhimi më të madh të ZRRUK-së për të arkëtuar taksat e licencimit nga ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave. Në këtë drejtim, rol të veçantë kishte riprogramimi i borxhit si një mekanizëm fleksibil për stimulimin e debitorëve për kthimin e borxheve të vjetra. ZRRUK, në përgjithësi kishte vënë kontrollë adekuate mbi të hyrat.

Ne nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Për vitin 2014, ZRRUK kishte zhvilluar procedura të prokurimit dhe kishte nënshkruar 23 kontrata në vlerë prej 17,119€, prej tyre 14 janë realizuar përmes procedurës së kuotimit të çmimit ndërsa 9 të tjera janë realizuar si vlera minimale (nën 1,000€).

ZRRUK, në përgjithësi ka vendosur kontrole relativisht të mira në këtë fushë.

Testimet tona nuk rezultuan me pasaktësi apo gabime materiale që do të ndikonin llogaritë financiare.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Fusha e shpenzimit e cila nuk i nënshtrohet prokurimit në ZRRUK kishte një prezencë më të madhe në totalin e shpenzimeve. Nga shuma prej 99,482€, pjesa më e madhe është shpenzuar për qera të objektit 45,185€ apo 45%, si dhe për kompensimin e anëtarve të Këshillave Komunale të Konsumatorëve me pjesëmarrje të shpenzimit prej 10,370€ apo 10%, pastaj komunalitë si dhe shpenzimet e tjera operationale kanë determinuar pjesën tjetër të mbetur të shpenzimeve.

Testimet tona nuk rezultuan me pasaktësi apo gabime materiale që do të ndikonin llogaritë financiare.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Në kategorinë Paga dhe Mëditje, ZRRUK kishte shpenzuar 188,454€ karshi buxhetit të ndarë prej 194,450€ që i bie të jetë 97%. Në buxhetin fillestar dhe final numri i lejuar i stafit prej 21 punëtorve, ndërsa për 2014 ZRRUK kishte aktualisht 19 punëtor.

Çështja 2 - Kompensimi për punët shtesë jashtë orarit të rregullt-Prioritet i mesëm

- E gjetura** Duke u bazuar në kërkesën e ZKF, në dhjetor 2014 drejtori i ZRRUK kishte nxjerrë një vendim, për kompensimin e punëve shtesë për pjesën dërmuese të stafit të ZRRUK-ut². Arsyeja e vendimit për shtesa mbështetëj në atë se pjesa dërmuese e stafit kishin më shumë përgjegjësi në ZRRUK. Megjithëkëtë, ne kemi vërejtur se nuk ishin bërë kërkesat përgjatë kohës kur është bërë puna, por ato ishin bërë në fund të vitit.
- Rreziku** Kërkesat për kompensimin e orëve për punët shtesë duhet të bëhen me kohë dhe të jenë në pajtim me rregulloret, në të kundërtën rritet rreziku për shpenzime jo korrekte.
- Rekomandimi 2** Drejtori i ZRRUK-ut duhet të rishikoj kërkesat për punë shtesë si dhe vendimmarrja të jetë plotësisht e harmonizuar me kuadrin ligjor dhe të jetë në kohë.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Kemi rishikuar këtë klasë të transaksioneve në lidhje me pohimet e menaxhmentit për informacionet e shpalosura në PVF, faktin se si janë mbajtur regjistrat si dhe a janë aplikuar normat e drejta të zhvlerësimit sipas UA 02/2013, poashtu kemi rishikuar procesin e rishikimit nga menaxhmenti për dëmtime të pasurive kërkesë e SNKSP.

Përgjegjësinë për administrimin e regjistrave të pasurisë, menaxhmenti i ZRRUK e kishte deleguar tek zyrtari i pasurisë, ky zyrtar kishte mbajtur dhe azhuruar dy regjistrat për evidentimin e pasurisë: regjistrin kontabël në të cilin janë të prezantuar pasuritë mbi 1,000€ dhe regjistrin e përgjithshëm të pasurisë në të cilin janë prezantuar të gjitha pasuritë përfshirë edhe ato me vlerë nën 1,000€. Në fund të vitit gjithashtu ishte bërë edhe inventarizimi i pasurisë.

Testimet tona nuk rezultuan me pasaktësi apo gabime materiale që do të ndikonin llogaritë financiare.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

² Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i ZRRUK nuk janë përfshirë në këtë vendim apo kompenzim.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrimi

Saldo e llogarive të arkëtueshme në PVF tregon vlerën prej 21,068€, dhe krahasuar me vitin e kaluar tregon një rritje prej 23%. Kjo rritje është refleksion i mos arkëtimit me kohë të taksës së licencim nga ofruesit e shërbimeve publike, të ujërave dhe mbeturinave. Gjendja e llogarive të arkëtueshme tregon se dy ofrues të shërbimeve (KRU Mitrovica si dhe kompania "KMDK" sh.p.k. nuk janë duke i shlyer obligimet sipas dinamikës së duhur. Lidhur me borxhet e vjetra të kompanive për menaxhimin e mbeturinave ZRRUK ju kishte ofruar lehtësime përmes riprogramimit të borxheve si alternativë adekuate për të mos i cenuar operationet e kompanive.

Çështja 3 - Politikat e ZRRUK-ut për Arkëtimet-Prioritet i lartë

- E gjetura** ZRRUK kishte dizajnuar sistemin e të kontrollit të brendshëm financiar, në përpjekje të funksionimit efektiv të saj. Megjithatë, llogaritë e arkëtueshme janë në rritje nga viti në vit. Buxheti vjetor i rregullatorit është kryekput i ndërlidhur me taksat e operatorëve të ujit dhe dhe i njejt i alokohet nga Ministria e Financave (MF) sipas planit dinamik të parasë së gatshme. Trajtimi i llogarive të arkëtueshme nga ZRRUK duhet të prioritizohet. Mbi të gjitha, në UA 01/2014 nuk ishin paraparë të aplikohen saksione të mundshme ndaj ofruesve të shërbimeve të cilët nuk i kryejnë obligimet e tyre me kohë.
- Rreziku** Mungesa e mekanizmave adekuat për trajtimin e arkëttimeve nga ZRRUK mund të sjellë rritjen e vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme. Kjo mund të ndikoj në vazhdimsinë e punës normale të organizatës, pasi që inkasimi i të hyrave vetanake nga ZRRUK ka ndikim edhe në proceset buxhetore..
- Rekomandimi 3** Drejtori i ZRRUK-ut duhet të insistoj që ofruesit e shërbimeve të shlyejnë me kohë dhe në mënyrë adekuate obligimet e tyre. Një alternativë e mundshme do të ishte ndryshimi i UA-së në mënyrë që të parashihen edhe masa të caktuara të cilat do të ndërgjegjësonin ofruesit e shërbimeve të jenë më të përgjegjshëm për sa i takon pagesës së taksës së licencimit.

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2014 ishte në shumën 2,707€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015, dhe të njejtat ishin kryesisht detyrime akruale por edhe fatura të papaguara të cilat ishin adresuar tek ZRRUK në fundin e vitit dhe me këtë rast nuk ishin paguar si pasojë e mbylljes së sistemit të Thesarit. Kjo shumë e obligimeve ishte shlyer në tërësi në muajt e parë të vitit vijues. ZRRUK në vazhdimësi ka treguar se ka kontrolle adekuate në këtë fushë.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. ZRRUK në përgjithësi ka pasur një qasje shumë proaktive në drejtimin e vlerësimit të funksionimit të kontrolleve të brendshme. Është praktikë e përvitshme që rregullatori të bëjë kërkesë nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NjQHAB), pasi që si entitet ZRRUK nuk mund të themeloj NJAB. Në këtë vit edhe pse është bërë kërkesa, ZRRUK nuk ishte subjekt i auditimit nga NjAB tjetër. Megjithatë, një përgjigje nga NjQHAB, duhet të sigurohet dhe të dihen arsyet e mosveprimit për kryerjen e auditimit të brendshëm në ZRRUK.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë

një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.4 Shpenzimet. Ekzekutimi i pagesave të cilat nuk ishin në përputhje me kontratën.	Drejtori i ZRRUK-ut duhet të siguroj se Zyrtari i certifikimit të pagesave do të verifikoj të gjitha kushtet e kontratës, dhe vetëm pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore të certifikohen pagesat.	Po		
4.4.3 Kompensimet (Pagat dhe Meditjet) Ndarje jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësi	Drejtori i ZRRUK-ut duhet të rishikoj mundësinë e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi në mes të menaxhimit të financave dhe menaxhimit të personelit, në mënyrë që të mos krijohet mundësi për konflikte të mundshme interesi			Jo
4.5.1 Trajtimi i Pasurisë kapitale dhe Jokapitale. Vonesa në regjistrimin e pasurisë	Drejtori i ZRRUK-ut në koordinim me zyrtarët përgjegjës të ZRRUK-ut, duhet të siguroj azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrimit kontabël të pasurisë, si dhe prezantimit të plotë të tyre në raportet financiare	Po		
4.5.1 Trajtimi i Pasurisë kapitale dhe Jokapitale. Mos funksionalizimi i sistemit E-pasuria	Drejtori i ZRRUK-ut duhet të shqyrtoj mundësinë, që në bashkëpunim me Ministrinë së Administratës Publike të vejë në funksion softuerin E-pasuria, në të cilin duhet të regjistrohen stoqet dhe të gjitha pasuritë nën 1,000€.	Po		